


Dr. sc. Besnik Fetahu



Ligjërues i lëndëve:

1. Shoqeria, Mireqenia dhe Siguria;
2. Metodologjia e Shkencave Shoqerore;
3. Puna Sociale;
4. Trajtimi dhe Rehabilitimi;
5. Programet e Rehabilitimit.

Besnik Fetahu ka përfunduar studimet postdiplomike në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filozofik – drejtimi Sociologji. Studimet e doktoraturës i ka përfunduar në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale – drejtimi Shkenca politike. Gjatë vitit 2015 ka qenë përfitues i programit Austrian Fellowship të financuar nga Qeveria Austriake – Ministria për Ekonomi, Shkencë dhe Huluntim (BMWFV), me të cilën ka realizuar hulumtim shkencor në fushën e politikave sociale me fokus në regjimet e shtetit social, pranë Universitetit të Graz-it – në Institut für Soziologie - Karl-Franzens-Universität Graz, nën mentorimin e Prof. Dr. Max Haller.

Po ashtu, është përfitues i Taiwan Fellowship Program për vitin 2016, të financuar nga Qeveria Taiwaneze, me të cilën do të vazhdoj hulumtimet e mëtutjeshme nga fusha e politikave sociale me fokus regjimet e shtetit social në Ballkanin Perëndimor, pranë National Taipei University.

Prej vitit 2010, ka qenë pjesë e Universitetit të Prishtinës, fillimisht si përgjegjës në mbështetjen e projekteve kërkimore shkencore, e pastaj nga viti 2011 edhe si përgjegjës për zhvillimin e programeve të studimit në nivel të Universitetit të Prishtinës. Gjatë vitit akademik 2013/14 ka qenë ligjërues i rregullt pranë Kolegjit AAB në Prishtinë dhe Ferizaj.

Tani është ligjërues i rregullt pranë Fakultetit të Sigurisë Publike, ndërsa është ligjërues i angazhuar në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

E-mail: besnik.fetahu@gmail.com

Tel: 028/590-070

**Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Fakulteti i Siguri Publike**

Vushtrri